

URDHËR
Nr. 270/2, datë 30.6.2021

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 351, DATË 29.5.2020,
“PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA DHE KUFIZIMEVE PËR
PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si edhe të vendimit të Komitetit Teknik nr. 2435, datë 27.5.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020, “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3, germa “b” shfuqizohet.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtje si vijon:

“2/1 Aktivitetet kulturore dhe teatrot të zhvillohen me kapacitet të reduktuar deri në 30% të spektatorëve apo pjesëmarrësve, në përputhje me protokollet e miratuara për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19 nga Instituti i Shëndetit Publik.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 1.7.2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu